



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo

<http://kk.rks-gov.net/istog/>



Komuna e Istog
Opština Istok
Istog Municipality

Tel: 038/200 438 14

KUVENDI I KOMUNËS/SKUPŠTINA OPŠTINE/MUNICIPAL ASSEMBLY ISTOG

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e shtatë e rregullt e Legjislacionit të VII-të të Kuvendit të Komunës së Istogut, mbajtur më: **26.09.2022**, në Sallën e Kuvendit të Komunës në Istog, filluar me punë në ora **10:00**.

Në mbledhje ishin të pranishëm këta këshilltarë:

- | | |
|--|------------------------------------|
| 1. <u>Enver Rugova, LDK;</u> | 15. <u>Ajshe Metaj, AAK;</u> |
| 2. <u>Hajrush Shoshi, LDK;</u> | 16. <u>Ardita Idrizaj, AAK;</u> |
| 3. <u>Faruk Kabashi, LDK;</u> | 17. <u>Negidet Ramaj, AAK;</u> |
| 4. <u>Haki Podrimaj, LDK;</u> | 18. <u>Fjolla Ukaj, AAK;</u> |
| 5. <u>Ruzhdi Metaj, LDK;</u> | 19. <u>Florin Dreshaj, VV;</u> |
| 6. <u>Faik Alushaj, LDK;</u> | 20. <u>Niman Beqiraj, VV;</u> |
| 7. <u>Veton Kurtaj, LDK;</u> | 21. <u>Qerim Rexhaj, VV;</u> |
| 8. <u>Arta Balaj, LDK;</u> | 22. <u>Floriana Maxharraj, VV;</u> |
| 9. <u>Njomza Demaj, LDK;</u> | 23. <u>Lavdiqe Bujupaj, VV;</u> |
| 10. <u>Liridona Lajçi Avdiaj, LDK;</u> | 24. <u>Visar Haxhijaj, PDK;</u> |
| 11. <u>Valbona Demaj, LDK;</u> | 25. <u>Andi Xhuraj, PDK;</u> |
| 12. <u>Agron Gashi, AAK;</u> | 26. <u>Era Visoqi, PDK;</u> |
| 13. <u>Arianit Selmanaj, AAK;</u> | 27. <u>Melis Smakic, GIBI.</u> |
| 14. <u>Nexhmedin Balaj, AAK;</u> | |

Mbledhja ishte e hapur dhe në mbledhje ishin të pranishëm: Kryetari i Komunës z. Ilir Ferati, Nënkryetari i Komunës, z. Ali Nimanaj, Drejtoret e Drejtorive, përfaqësues të OSBE-së, KFORI-të zyrtarë administrativ si dhe media lokale RTV - Fontana (lista e nënshkrimeve të evidencës së pjesëmarrjes është pjesë përbërëse e këtij procesverbali dhe e njëjta gjendet në dosje: "shembulli 1")

(Ecuria e tërë mbledhjes është xhiruar edhe CD-te e xhirimit gjenden në dosje: "shembulli 2").

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës z. Enver Rugova.

Kryesuesi i Kuvendit, z. Enver Rugova – përshëndeti të gjithë të pranishmit në këtë mbledhje. Hap punimet për mbledhjen e gjashtë të rregullt të Legjislacionit të VII-të dhe për këtë mbledhje propozoi këtë rend dite:

Procesverbali

Konstaton Kuorumin për mbajtjen e mbledhjes (27) anëtarë të Kuvendit janë të pranishëm.

Vazhdojmë me mbledhjen :

R E N D D I T E

1. Arsyetimi i mungesave në mbledhje,
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
3. Shqyrtimi dhe miratimi i Projekt Rregullores për ndarjen e bursave,
4. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës së KRM "Ambienti" njësia operative Istog, për ngritjen e çmimit të shërbimit të grumbullimit, transportit dhe deponimit të mbeturinave,
5. Shqyrtimi dhe miratimi i Draft Buxhetit për vitin 2023-2025.
6. Miratimi i Transferit të mjeteve buxhetore të mbetura për bartje nga Kategoria Ekonomike 38-Rezerva në Kategorinë Ekonomike,30-Shpenzime Kapitale në shumë prej-400,000.00€.
7. Shqyrtimi dhe Miratimi i projektit të ri kapital në bashkëfinancim me komunitetin për projektin "Ndërtimi I rrugëve në lagjen Osmanaj në Prekallë dhe Lagjen Blakaj në Llukavc të Begut" në vlerë prej 14,000.00 euro.
8. Shqyrtimi dhe miratimi i Bartjes së mjeteve buxhetore të mbetura në vlerë prej: 12,987.00€, nga viti 2019, 2020 nga të hyrat vetanake të pa shpenzuara në vitin 2022,
9. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim vendimit për destinimin e pronave të paluajtshme të komunës për aktivitete sportive.
10. Ndërrimi i emrit të projektit "Drenazhimi i fushës së sportit Demush Mavraj" me emrin e ri të projektit "Ndërtimi i Murit Rrethues të Stadiumit Demush Maraj".

Në bazë të listës së nënshkrimeve dhe prezencës tuaj këtu prezent janë 27 të gjithë anëtarë të Kuvendit.

Kryesuesi i Kuvendit – a ka dikush diçka nga anëtarët e kuvendit apo nga ekzekutivi.

Niman Beqiraj – përshëndet të gjithë të pranishmit, propozon që pika e katërt e rendit të ditës, Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës së KRM "Ambienti" njësia operative Istog, për ngritjen e çmimit të shërbimit të grumbullimit, transportit dhe deponimit të mbeturinave në e KPF-së e kemi lënë që të plotësohet me material shtesë dhe të sqarohet kjo pikë e rendit të ditës pse ne ta votojmë kur nuk e dimi, të shtyhet për mbledhjen e ardhshme pasi që nuk ka material shtesë në mbledhjen.

Kryesuesi i Kuvendit – materiali fill pas përfundimit të mbledhjes ju ka ardhur dhe këta nuk kanë pasur kohë që ta punojnë një raport ndoshta është edhe faji jonë

Niman Beqiraj – kryesues unë pot kuptoj ty por këta kanë mundur të na dërgojnë.

Drejtori për Shërbime Publike, Abedin Kabashi – përshëndet të gjithë të pranishmit – materialin nuk kemi pasur kohë ta dërgojmë me material, unë tani e kom në kopje fizike dhe mund tua shpërndaj.

Niman Beqiraj – kjo është e mjaftueshme por është shumë kohë e shkurtet ne duhet ti sqarojmë qytetaret se pse po shtrenjtohen mbeturinat, sepse ne jemi për ata këtu e kuptoj drejtorin dhe për korrektsin që e shfaqti këtu por kjo nuk mjafton.

Kryesuesi i Kuvendit – hedh në miratim kush është që kjo pikë të hiqet nga rendi i ditës 11 vota për, 15 kundër

Konstatohet që pika e katërt e rendi të ditës mbetet në rend të ditës që të shqyrtohet në këtë mbledhje.

Hedhe në miratim komplet rendin e ditës rendin e ditës Kush është për?

Miratohet Rendi i Ditës me 21 vota për dhe 5 kundër

Konstatohet që me 26 anëtar janë prezent

Shqyrtimi i pikës 1.

Kryesuesi i Kuvendit- në mbledhjen e sotme mungon nuk mungon askush.

Shqyrtimi i pikës 2.

Kryesuesi i Kuvendit – Procesverbalin e keni pa a ka dikush ndonjë vërejtje.

Hedh në miratim

Miratohet unanim

Konstatohet që me 26 vota për aq sa janë të pranishëm miratohet procesverbali i mbledhjes së kaluar i datës 29.07.2022.

Shqyrtimi i pikës 3.

Kryesuesi i Kuvendit - vazhdojmë me piken tjetër Shqyrtimi dhe miratimi i Projekt Rregullores për ndarjen e bursave.

Drejtori për Arsim z. Naim Belulaj - përshëndet të gjithë të pranishmit, bën prezantimin dhe sqarimin e Projekt Rregullores për Ndarjen e Bursave.

Agron Gashi - përshëndet të gjithë të pranishmit, Agron Gashi - përshëndet të gjithë të pranishmit, e pash këtë pjesë që është shtuar sa i përket klasës së 12 po a është konsultuar për kriteret e vlerësimit të këtyre bursave se këto dallojnë me këto të fakulteteve, me i shikuar pasi që thatë janë lënde profesionale të cilat lënde janë me deficitare për komunën si është kriteri i vlerësimit për këto bursa të bëhet një analizë apo sa bursa kanë me u dhënë për këta. Edhe pjesa që e kam thënë se i kemi pasur në komisionin e kaluar me ATK- në e tjerat, edhe notën mesatare 9.0 që e kemi diskutuar nuk po e shohë të arsyeshme me u diskutuar kur ata kanë bursa atje spo po kanë shpenzime me i paguar noterin , ATK-në udhëtimi me shkuar në Peje e me u kthye edhe

nuk i pranohet aplikacioni sepse merr bursën nga fakulteti. Dua ta pyes drejtorin sa i përket bursave të nxënësve normal kriteret duhet të jenë krejt ndryshe, ndërsa në Rregullore nuk ka kriterë hiq, të shtohet komplet si pjesë.

Drejtori i Arsimit, z. Naim Behlulaj - sa i përket notës mesatare nëse vazhdojmë me klasën e 12 është mbetur nota mesatare 4, nëse fillojmë prej klasës së 10 do të jetë 4.5 por kjo ka mbetur që të vendosni ju si Kuvend. Ndërsa të studentet nota mesatare 9 duke u bazuar në Rregullore dhe Ligje nuk guxojmë me ja mohu se aj mundet me qen përfitues i bursës universitare por nuk donë me marr bursën universitare por donë me marr këta komunale ndërsa komisioni mbetet të verifikohet. Sa i përket drejtorit të administratës nuk kemi drejt me i pra diplomat pa i noterizu.

Haki Podrimaj - përshëndet të gjithë të pranishmit, kam vërejtjet e mia të neni 1 këtu janë përjashtuar kolegjet private, dua të di pse janë përjashtuar ku i njëjti institucion i licencon private dhe publiket. Kemi mjaft shembuj ku pa dëshirën e tyre studentet detyrohet të shkojnë në kolegje private p.sh në fakultetin e mjekësisë kanë konkurruar për 250 vende 1000 veta prej tyre 1000 vetave janë pranuar 250 ku 750 student kanë mbetur rrugëve dhe janë detyruar që të regjistrohen nëpër kolegje private për mos ta humbur një vite. Mos të ua shkelim të drejtën fëmijëve tanë. Të lëndët deficitare po pajtohem aty i kemi disa drejtime deficitare faktikisht për arsim ku është Matematika, Fizika dhe Kimia pajtohem.

Të kushtet për konkurrim neni 7 pika 1.6 nuk kanë të drejt të aplikojnë nxënësit me infermieri dua të di pse ? Pika 3 lista e Shangait këtu ka dalim mes kolegjeve ku për studime jashtë vendit ka të drejt studenti të aplikoj për bursë ku shumica e tyre shkojnë me bursë universiteti ndërsa kolegjet private brenda vendit nuk kanë të drejt të aplikojnë. Të neni 9 kriteret e vlerësimit të bursave lexon piken 1 pajtohet, por pika 1.5 në kundërshtim me piken 1 dhe kjo pik duhet të hiqet.

Nuk pajtona të nota mesatare në bazë të drejtimeve që ta kenë të njëjtën notë mesatare. Të hiqet nota mesatare mos të vlerësohet me poena.

Florin Dreshaj - përshëndet të gjithë të pranishmit, të kolegjet private është dashur një numër i caktuar jo i madhe për shkak se ata e din si merren notat në kolegjet private dhe nëse hynë në konkurrencë fitojnë veten kolegjet private edhe aty ka studente të mirë dhe nuk i kanë kushtet e mira por për arsye të ndryshe siç e tha edhe parafolësi janë imponuar që të jenë aty, këtu të jetë një numër i vogël i kufizuar që mos të i largojmë krejt nga kjo mundësi. Të pika 4 cila është arsyeja pse nuk kanë filluar bursat nga klasa e 10, a ka mjete të mjaftueshme këtu që me filluar nga klasa e dhjetë apo duhet ti lemë nga klasa e 12. Të pika 5 lëmit deficitare ne e kemi parë konkursin për mësimdhënës ku ka pasur lëndet që është kërkuar mësimdhënës dhe nuk ka pasur as një aplikues si p.sh gjuha Gjermanë dhe disa tjera ku ka pas konkurse po nuk ka pas konkurrent është dashur të përfshihen edhe ato.

Ajshe Metaj - përshëndet të gjithë të pranishmit, të arsimit i mesën i lartë është bërë një ndarje mese klasave të 10ta dhe të 12ta, arsyen e kuptuar nga drejtori për shkak të barrës financiare të komunës por pasi që i takon të njëjtës kategori të arsimit mendoj që nuk duhet të ndahen klasat të merret një qëndrim ose tu ndahet shkollave të mesme me kriterë të përcaktuara me Rregullore ose të përfshihen të dyja.

Niman Beqiraj - të kolegjet private, nuk duhet të largohen nga çështja e bursës sepse pastaj po kemi probleme në lëndet deficitare p.sh nëse e përfundon në një fakultet privat dhe ne kemi mungesë a pranohet në punë a person?

Naim Behlulaj - kjo Rregullore është punuar nga komisioni dhe kolegjet private nuk janë hy për arsye së Ministria me planin strategjik 2022-25 nuk e ka paraparë ndarjen e bursave për kolegjet private. Infermiera nuk ka hy si lëndë deficitare sepse kemi mjaft infermier dhe nuk është hy në Rregullore. Sa i përket listës së Shangait ne jemi duke ju ndihmuar studentëve që i kemi jashtë, të investojmë pak në ta që të kthehen dhe të punojnë këtu sepse ka shumë pak.

Te familjet e ngushta të dëshmorëve janë të përcaktuar me ligj. Nota mesatare e kemi vendos mos me ja mohu të drejtën pasi që ka mundësi me zgjedh bursën. Ju si Kuvend mund të merrni vendime këtu. Ndarja e bursave në shkollën e mesme Ministria e Arsimit e ka aplikuar për herë të parë që të ju ndahen bursa nxënësve në shkollat profesionale.

Të nota mesatare nuk është kriter për konkurrim.

Hajrush Shoshi - përshëndet të gjithë të pranishmit, ATK-ja mund të nxirret online. Të klasa e 10të vendoset që të marrin bursa janë shumë arsye që vitin e parë pritojnë nxënësit që të regjistrohen në shkollat profesionale edhe politika e ministrisë së arsimit është që ti ipet prioritet shkollave profesionale ne mund ta kufizojmë bursën që të jetë vetëm për shkollat profesionale dhe vetëm për një vitet shkollor, klasave të 10ta tu mundësohet bursa sepse kemi nxënës nga Kalijani ku shumë ma lehtë shkojnë në Pejë të tërheqim nxënësit me bursa apo subvencione tjera ku unë kam menduar që ta kemi edhe një linjë të autobusëve për shkollën profesionale në të dy drejtimet por kjo duhet të diskutohet.

Të nota mesatare kriteret e vlerësimit nota ose ta vendosim notën mesatare ose ta heqim krejt.

Ti qesim secili propozimet e veta në votim.

Kryetari i Komunës z. Ilir Ferati - përshëndet të gjithë të pranishmit, e dëgjova me vëmendje secilin diskutim, ideja ka qenë të përkrahen studentet e mirë dhe këta student i dallon nota mesatare, e di që nuk janë fakultete e njëjta, secili student në shkollën e mesme e merr orientimin së në cilin fakultet do të shkojë çka është obligim i yni si ekzekutiv edhe me ndihmën e juaj ti përkrahim njerëzit që po investojnë në dije që nëse na duhen ti zënë vendet e kuadrove siç i përmendet me herët, po kemi problem në konkursin e fundit për kuadro ku në të ardhmen do të kemi edhe me problem, të investojmë në studentë që regjistrohen në këto fakultete suficitare përmes kësaj rregullorja që bursat të ndahen në dy faza e para dhe e dyta, e para ku hynë të gjitha kategoritë edhe ato sociale ndërsa e dyta për studentet me nota mesatare, por nga as njëra nga këto faza nuk largohen kategoritë e dala nga lufta ashtu siç parashihi me ligj, studentet të cilët kanë notën mesatare të lartë edhe mendojnë që pasi ta përfundojnë fakultetin të hynë në punë në vendin tonë dikund të kontribuojnë, ti stimulojmë me bursa. Ka kuadro të mjaftueshme të ju ndihmojmë sado pak.

Kryesuesi i Kuvendit - ti hedhim në votim të gjitha propozimet që u dhanë vetëm me duhet një sqarim nga propozuesit.

Haki Podrimaj - të neni 9 pika 1 (lexon pikën) këta po lirohen dhe janë përfitues të bursave automatikisht, teknikisht është gabim të hiqet mos të keqkuptohet.

Kryetari i Komunës - sqaron nenin 9 pikë 1 dhe piken 1.5, dallimin mes tyre.

Kryesuesi i Kuvendit - hedh në votim propozimin e Haki Podrimaj a jeni që kolegjet private të hynë në Rregulloren e komunës për përfitimin e bursave
Kush është për?

10 vota për, 13 kundër, 1 abstenim

Të pranishëm 24 anëtar të KK

Nuk kalon që të hynë në Rregullore kolegjet private.

Që të hiqet nota mesatare kush është për?

7 vota për, 14 kundër, 1 abstenim

Të pranishëm 22 anëtar

Nuk kalon propozime që të hiqet nota mesatare. (mbetet nota mesatare në kriteret e Rregullores)

Neni 7 të hiqet pika 1.6 që nxënësit e infermeris të mos jenë të përfshirë në dhënien e bursave.

Hedh në votim, kush është për?

Agron Gashi - për me i tejkaluar këto e kam dhënë një propozim herën e kaluar që bursat të ndahen në bazë të kriterëve në bazë të fakulteteve me mënjano edhe notën mesatare që me konkuruar mjekësi me mjekësin, jo mjekësia me edukimin së është nota ndryshe p.sh nëse epen 100 bursa 20 prej tyre epen në mjeksi në kuader të tyre studentet e mjekësisë aplikojnë për bursë dhe i kanë notat e tyre në profilin e tyre edhe e mënjano edhe këtë pjesën e infermierisë që kur të hapet konkursi për bursa nuk e qet infermierin hiq nuk mund ti thuash një studenti që mos apliko se ski drejt por nuk e qet në kriteret infermierin i ndan neper drejtime ku do ti japësh bursat dhe studentet aplikojnë për ato drejtime të caktuara me notën mesatare të tyre. Ky kriter i ndan të gjitha se nuk mund ta ndash infermierin, sepse pas 4 vitesh mund të kesh nevojë për të. Kur ti ndash këto është edhe të nota mesatare i ki studentet të të njëjtës lëmi - kategori që konkurrojnë dhe nuk përzihen me pjesë tjera. Te ATK-ja është lehtë me e nxjerr online por aty nuk përcakton a është i punësuar prindi a jo. Kështu që enti i punësimit në Istog e përcakton me së miri se e merr nga ministria se kush merr pagë nga shteti dhe është me e lehtë për student.

Hajrush Shoshi - vetëm ta sqaroj këtë ne e patëm fjalën të mos jetë nxënës i infermierisë të shkollat e mesme nuk ka të bëjë kjo me studente është të shkolla e mesme profesionale unë prapë qëndroj pas asaj që nuk duhet të marrin.

Niman Beqiraj - në KPF ka mbetur që nën kriteret të largohen nga Rregullorja, dua sqarim nga drejtori në mënyrë që të kemi sa më të qartë se çka po votohet.

Drejtori i Arsimit, Naim Behlulaj - sa i përket kriterëve ne vetëm i kemi caktuar në bazë të Rregullores por në mbledhjen e KPF-së, ka mbetur nëse kemi me shtuar diçka më shumë në Kuvend këto kanë qenë që jemi marr vesh.

Florin Dreshaj - nuk mendova numrin e caktuar i fakulteteve por i studentëve të cilët do merrnin bursës por kjo vetëm se u miratua dhe nuk hyn fakultetet private. Mendoj çka nuk na lejon ligji nuk është dashtë me e qit.

Kryesuesi i Kuvendit - hedh në votim piken 1.6 të nenit 7,
Kush është që të mos hiqet pika 1.6 që nxënësit e infermierisë të jenë përfitues të bursave

10 vota për, 10 kundër, 4 abstenime

Të pranishëm 24 anëtar të Kuvendit

Pasi që votimi është i barabartë kryesuesi ka të drejt votën e dyfishtë

Dhe kryesuesi vendos që të mbetet ashtu siç është propozuar nga komisioni për hartimin e Rregullores që nxënësit e infermieres të mos jenë fitues të burës.

Ajshe Metaj - unë kam qene që mos me u përjashtu medicina, kam qene qe nëse epen bursa për shkolla të mesme mos me u diskrimino të dhjetat e të 11, jam që mesatarja e arsimit të mesëm të lart me u respektuar. Nëse po flitet për shkolla profesionale a është duke u përjashtuar infermiera apo është duke u folur për gjimnaz ketë nuk e kuptova!

Hajrush Shoshi – sa i përket infermieres është në shkollën e mesme profesionale dhe nëse vendoset që infermiera të jetë pjesë e bursave ata do të jenë të gjithë përfitues të bursave sepse ata kanë notat e larta. Ndërsa në shkollën profesionale ka nxënës që regjistrohen me dysh dhe tresha, ti shikojmë pak këto gjëra a po dojm me i përkrah nxënësit apo politikat e ministrive.

Kryesuesi i Kuvendit – ta bëjmë një Rregullore që vërtet na duhet dhe mos me ra në desh me ligjin e me na kthye Rregulloren sepse po kemi problemi pastaj dhe procedurat po zgjaten.

Agron Gashi – e dhashë një propozim si mund të bëhet sepse është e keqe me e diskriminua dikënd në konkurs.

Visar Haxhijaj – përshëndet të gjithë të pranishmit, dua të ndërlidhem me Harushin që po thotë me i diskriminuar se ky është i mësuar të diskriminoj është kundër që ti jep bursa njerëzve qe e kanë kryer në provat. Ndërsa ky i ka pranuar njerëzit me jep mësim me privat në Istog i ka diskriminuar këta të shtetit, a këtu del kundër me ju nda bursa.

Kryesuesi i Kuvendit – a ka dikush diçka tjetër,

Hedh në miratim

Miratohet me 25 vota për dhe 1 abstenim

Me mbledhje prezent 26 anëtar të Kuvendit të Komunës.

Shqyrtimi i pikës së 4.

Kryesuesi i Kuvendit- vazhdojmë me piken tjetër, Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës së KRM “Ambienti” njësia operative Istog, për ngritjen e çmimit të shërbimit të grumbullimit, transportit dhe deponimit të mbeturinave,

Drejtori i shërbimeve publike z. Abedin Kabashi – përshëndet të gjithë të pranishmit, , bën prezantimin dhe sqarimin e kërkesës së KRM “Ambienti” njësia operative Istog, për

ngritjen e çmimit të shërbimit të grumbullimit, transportit dhe deponimit të mbeturinave.. E kërkoj që ta përkrahni këtë ngritje të tarifës.

Niman Beqiraj - KRM "Ambienti" është kompani e suksesshme ndoshta edhe në financa siç e kemi parë po ashtu edhe në teren, normal që e vlerësojmë por kur të është puna të çmimi, çmimi ka qenë 4 euro e diçka është bere 5 dhe tani po donë me u bë 6, vitin tjetër mundet hala me u shtrenjtuar nëse i morim raportet e viti 2021 e shohim që ka pasur 84000 euro fitim është e pa nevojshme kjo është kompani nga e cila nuk kërkohet fitim por kërkohet shërbim nëse ka pasur 84 mijë euro në vitin 2021 e në gjashtë mujorin e vitit të parë të këtij viti tash ka pasur fitim 8000 euro ndërkaq një raport që na ka ardhur për tre muajt e fundit ka pasur humbje prej 5mijë euro ku në fakt ata ende janë plus KRM "Ambienti" nuk po mendoj që ne duhet të votojmë e tua shtrenjtojmë shportën qytetareve tanë edhe me një euro shtesë në muaj për shkak që është e pa nevojshme së KRM "Ambienti" ka kapacitet ende me e mbajt veten. Komuna ka të drejt edhe me e subvencionuar mirë po ka të drejt edhe me e pruar një ngritje çmimi në momentin kur nuk funksionon mirë po me këto të dhëna që ne i kemi këtu.

Hajrush Shoshi – nuk janë 84mijëeuro fitim vitin e kaluar po janë 22 mijë euro mirë po të gjithë po e dimi situatën që është e rend për qytetaret dhe për ne nuk është e lehtë që të ngrisim dorën qeta ngrisim këtë çmim për një euro mirë po a është e arsyeshme është e arsyeshme kur po i shohim ngritjen e çmimeve. Kompania do të ketë probleme edhe në inkasim të mjeteve sepse ata që nuk do të kenë nuk do ta paguajnë. Kërkoj nga të gjithë që ky ndryshim i çmimit të aprovohet dhe të votohet.

Niman Beqiraj – Përpara e kam tabelën me të dhënat të cilat na i ka sjell KRM "Ambienti" dhe këtu shihet që ka pasur inkasim mbi 500mijë euro ndërkaq totali i shpenzimeve për periudhën ka qenë mbi 416 mijë euro ku do të thotë mbetja është mbi 84mijë euro.

Haki Podrimaj – deri sa e kam mbarur këtë raport bindja ime ka qen me votuar kundër kam menduar që kanë një afarizëm me të mirë dhe jo në këtë që është duke shkuar për tre muaj 5000 euro, nuk është e lehtë që në këtë gjendje ekonomike çfarë jemi ti i grisim dorën për rritje prapë dhe qytetaret nuk e kanë gjendjen aq mirë sa për me i ngrit ne këto çmime. Por që mos të keqësohet gjendja e kompanisë po i përkrahim.

Kryetari i Komunës z. Ilir Ferati - është e vërtet kjo çka po e thotë Hakia dhe raporti që është raportuar në situatën të cilën jemi dhe në rrethanat të cilat po jetojmë një familje 5 anëtarësh me 2000euro nuk krijon stabilitet, jo një kompani siç është Ambienti që i jep shërbim 52 fshatrave 440 kilometra katror, nuk është në rregull me thënë 20% , ne jemi dëshmitar të shumë rritjeve të çmimeve e që nuk na ka pyetur kush. Kam shumë ankesa nga qytetaret që nuk po mund ta paguajnë rrymën dhe shërbimet tjera. Ne jemi duke u munduar ta shpëtojmë këtë ndërmarrje, dhe të sigurohet një qytet i pastër. Mos ta bëjmë që këtë ndërmarrje ta ndihmojmë me subvencione.

Niman Beqiraj – ne prape do të votojmë kundër për shkak se unë ju besoj numrave që i kam përpara, pos kësaj shpenzimet e mirëmbajtjes dhe prapë ka dal plus nëse ne do ta krijojmë një kompani që gjeneron të hyra e përfitojmë ne nga ajo e që është evidente por sa i përket përfundimit të shërbimit që ata e bëjnë, mendoj që momentalisht nuk është e nevojshmes të shtrenjtohet sepse janë plus e kemi edhe raportin nga janari deri sot është

plus. Për mendim timin është duke funksionuar mirë është e pa nevojshme, nëse këta kanë nevojë për shpenzime shtesë ne jemi këtu që të ju ndihmojmë. Ne si LVV votojmë kundër.

Agron Gashi – u përmenden shumë sende këtu gjendja ekonomike e pa përballueshme inflacioni, mirë po të njëjtën gjendje e kanë edhe qytetaret, nëse është mënyra me i subvencionuar mos tua mori qytetarëve nga një euro hiq, sepse çdo produkt nga një euro me shumë, kështu që edhe ne jemi kundër këtij propozimi.

Kryesuesi i Kuvendit – a ka dikush diçka,
Hedh në miratim kërkesën e KRM “Ambienti” njësia operative Istog, për ngritjen e çmimit të shërbimit të grumbullimit, transportit dhe deponimit të mbeturinave
Hedh në votim
Miratohet me 14 vota për dhe 11 kundër
Të pranishëm 25 anëtar të Kuvendit të Komunës

Shqyrtimi i pikës 5.

Kryesuesi i Kuvendit- vazhdojmë me piken në vazhdim, Shqyrtimi dhe miratimi i Draft Buxhetit për vitin 2023-2025.

Zyrtari Kryesor Financiar, z. Osmon Sadikaj – përshëndet të gjithë të pranishmit, bën prezantimin dhe sqarimin e Draft Buxhetit për vitin 2023-2025.

Kryetari i Komunës, z. Ilir Ferati – sqaron në detaje e dëgjimeve publike dhe projekteve që janë në Draft Buxhetit për vitin 2023-2025, po ashtu shpreh edhe pakënaqësinë që ka pasur për pjesëmarrjen e qytetarëve në këto dëgjime publike, një numër shumë i vogël i pjesëmarrjes së qytetarëve.

Fjolla Ukaj – Zyrtari tha se mund ta heqim një projekt dhe ta qesim një tjetër tri projekte janë komplet sa i përket rajonit të Banjës nuk mund ta them se cilin me e hiq, me prioritet unë kisha thënë së është edhe rruga e Livadheve e cila gjindë në fshatin Lubovë 450metra fatkeqësisht është në gjendje të mjerueshme, pas postes është rruga Rrozhaja nuk ka kanalizim e as ndriçim. Rruga për Pejë në Baicë është kanali i ujitjes nga reshjet atë zonë i merr vërshimet në mënyre urgjente të ndermirret diçkanë atë pjese, si dhe është trotuari nga qendra e mjeksis familjare në fshatin Banjë nuk ka trotuar afër qendrës fare, renovimi i shtëpisë se kulturën në Banjë është në gjendje të mjerueshme përballa xhamisë është interverizimi. Mendoj se edhe këto duhet të hynë si projekte por unë nuk kam diçka këtu me pjek. Rruga në Lubov dhe kanali i ujitjes të merren si prioritate.

Ajshe Metaj – të ministria e financave nëse aplikohet ligji i ri i pagave çka kemi planifikuar ne në buxhet. Kërkoj nga ekzekutivi që me u identifiku prioriteti i projekteve, të respektohet projektet me prioritet. Uji është prioritet problemi i mbivades a është zgjidhur a jo kemi nda mjete edhe vitin e kaluar, po këto janë çështje që do ti diskutojmë një herë tjetër, menjëherë pas ujit të pijes të jetë kanalizimi, këto prioritet të projekteve kapitale me i rishikuar dhe me i vendos aty ku duhet sepse kjo është në të mirë të qytetarëve të gjithë ne këtu jemi fal votave të qytetarëve.

Haki Podrimaj – këto janë prioritetet e kryetarit dhe ekzekutivit nga propozimet e qytetarëve që i kanë mbajtur për buxhet, dhe gjatë fushatës prandaj këto janë prioritetet e propozuara nga qytetarët që duhet kryetari me i zbatuar gjatë mandatit të tij. Edhe ne si këshilltar komunale i kemi disa projektet që duam ti shtimi në këtë buxhet. Nuk janë vetëm këto projektet por ka edhe linja tjera financiare siç e tha e ZKF-ja se mund të kryhen nga donacionet e jashtme kemi përvoja edhe nga vitet e kaluara, se më shumë kemi përfunduar projekte nga të hyrat tjera me donacione. Ne si grup i LDK-së jemi pro këtij buxheti.

Hajrush Shoshi – të gjithë kemi vend për propozime por e përgëzoj ekzekutivin që e ka bërë një buxhet kaq të mirë, kam një propozim që rrethoja e shkollës Uçë dhe shkollës “Ndërmjeda” Rakosh që është 20mijë euro të shkojnë që të rregullohet poligoni i shkollës në fshatin Kaliban, është një shkollë se bukur ka here nuk është investuar, ndërsa edhe këto rrethoja mund ta punojnë bashkë me projektin ndërtimi i rrethojave të shkollave të Istogut që është 50mijë euro. Është i arsyeshëm poligoni i shkollës së Kalibanit të ndërtohet.

Zyrtari Kryesor Financiar, Osmon Sadikaj – Fjolla i propozoj shumë qartë disa projekte por e tha të hynë si projekte të reja, të gjitha këto projekte do ti fusim të burimet e tjera të financimit sigurisht do të gjejmë donacione apo financime për vitin 2023. Ajshe ligjin e pagave ne duhet ta planifikojmë buxhetin siç e kemi nëse Ligji i Pagave kërkon shtesë Ministria e Financave ka mjete rezervë. Hajrush këto projekte me procesverbal do të hynë prapë në strategjinë e Komunës.

Kryesuesi i Kuvendit- faleminderit anëtarët e kuvendit, a ka dikush diçka, pasi që diskutime tjerët nuk keni.

Hedh në votim Draft Buxhetit për vitin 2023-2025 .

Miratohet me 16 vota për 1 kundër dhe 4 abstenim.

Konstatohet që me 21 anëtar të Kuvendit janë prezent në sallë.

Shqyrtimi i pikës 6.

Kryesuesi i Kuvendit – vazhdojmë me piken e gjatë Miratimi i Transferit të mjeteve buxhetore të mbetura për bartje nga Kategoria Ekonomike 38-Rezerva në Kategorinë Ekonomike,30-Shpenzime Kapitale në shumë prej-400,000.00€.

Zyrtari Kryesor Financiar, z. Osmon Sadikaj – bën prezantimin dhe sqarimin e Transferit të mjeteve buxhetore të mbetura për bartje nga Kategoria Ekonomike 38-Rezerva në Kategorinë Ekonomike,30-Shpenzime Kapitale në shumë prej-400,000.00€.

Kryesuesi i Kuvendit - faleminderit anëtarët e kuvendit, a ka dikush diçka, pasi që diskutime tjerët nuk keni.

Hedh në votim Transferit të mjeteve buxhetore të mbetura për bartje nga Kategoria Ekonomike 38-Rezerva në Kategorinë Ekonomike,30-Shpenzime Kapitale në shumë prej-400,000.00€.

Miratohet unanim nga anëtarët e Kuvendit të Komunës.

Konstatohet që me 22 anëtar të Kuvendit janë prezent në sallë

Shqyrtimi i pikës 7.

Kryesuesi i Kuvendit - kalojmë në piken tjetër Shqyrtimi dhe Miratimi i projektit të ri kapital në bashkëfinancim me komunitetin për projektin "Ndërtimi I rrugëve në lagjen Osmanaj në Prekallë dhe Lagjen Blakaj në Llukavc të Begut" në vlerë prej 14,000.00 euro.

Zyrtari Kryesor Financiar, z. Osmon Sadikaj – bën prezantimin dhe sqarimin e projektit të ri kapital në bashkëfinancim me komunitetin për projektin "Ndërtimi I rrugëve në lagjen Osmanaj në Prekallë dhe Lagjen Blakaj në Llukavc të Begut" në vlerë prej 14,000.00 euro.

Ajshe Metaj – a ka edhe projektet tjera me bashkëfinancim, apo janë vetëm këto dyja.

Zyrtari Kryesor Financiar, z. Osmon Sadikaj – të gjitha projektet me bashkëfinancim jemi të obliguar që ti qesim në kuvendi për miratim.

Kryesuesi i Kuvendit - a ka edhe dikush diçka rreth kësaj pike?

Hedh në votim,

Miratohet unanim nga anëtarët prezent.

Të pranishëm në sallën e Kuvendit janë 22 anëtar .

Shqyrtimi i pikës 8.

Kryesuesi i Kuvendit – vazhdojmë në piken tjetër Shqyrtimi dhe miratimi i Bartjes së mjeteve buxhetore të mbetura në vlerë prej: 12,987.00€, nga viti 2019, 2020 nga të hyrat vetanake të pa shpenzuara në vitin 2022.

Zyrtari Kryesor Financiar, z. Osmon Sadikaj – bën prezantimin dhe sqarimin e Shqyrtimi dhe miratimi i Bartjes së mjeteve buxhetore të mbetura në vlerë prej: 12,987.00€, nga viti 2019, 2020 nga të hyrat vetanake të pa shpenzuara në vitin 2022.

Ajshe Metaj – me sa e di unë ky projekt apo këto 12,987.00€, ka qen subvencionimi i blegtorëve që gjën jua ka sulmuar kafshët edhe është një mbështetje shumë me vende. Kam një pyetje, sa raste janë lajmëruar se kanë dëme edhe a mjafton kjo shumë me i subvencionuar të gjithë ata që janë lajmëruar.

Zyrtari Kryesor Financiar, z. Osmon Sadikaj – po Ajshe është i njëjti projekt me bashkëfinancim. Sa i përket dëmeve të shkaktuara sigurisht që ka me pasur edhe me shumë se ne nuk mund të paragjykojmë se sa ka me pasur.

Kryesuesi i Kuvendit - a ka dikush diçka?

Pasi që nuk ka e hedh në miratim

Miratohet unanim nga anëtarët prezent ne mbledhje.

Konstatohet që janë 21 anëtarë të Kuvendit të pranishëm në sall.

Shqyrtimi i pikës 9.

Kryesuesi i Kuvendit- kalojmë piken e radhës Shqyrtimi dhe miratimi i propozim vendimit për destinimin e pronave të paluajtshme të komunës për aktivitete sportive.

Drejtori për kadastrë dhe Gjodezi, z. Agon Dreshaj – përshëndet të gjithë të pranishmit bën prezantimin dhe sqarimin e Shqyrtimi dhe miratimi i Propozim Vendimit për destinimin e pronave të paluajtshme të komunës për aktivitete sportive.

Fjolla Ukaj – keni pasur një kërkesë dhe disa takime me klubin e Onixi ku ka arrit epilogu dhe kur do të marrin një përgjigje përfundimtare ata.

Kryetari i Komunës z. Ilir Ferati – kemi pasur disa takime me klubin Onix dhe janë takime që po vazhdojnë kanë qenë takime dhe të mandatit të kaluar ne i kemi shti në listën e pronave për dhënie në shfrytëzim dhe pronat që ata i kanë propozuar. Në takim me ministrin Qeku kemi diskutuar shkëmbimin e pronave pasi që ekziston një pronë e AKP-së e cila nuk shfrytëzohet nga askush dhe ajo pronë ti epet klubit Onix dhe komuna të filloj me procedurat e shkëmbimit të pronës, ky ka qenë propozim i ministrit, ministria ka filluar të kontaktoj me AKP-në dhe besoj se shpejt do ta kemi një përgjigje.

Ajshe Metaj – e përgëzoj kryetarin dhe krejt ekzekutivin në përgjithësi se kontribuojnë në sport. Vetëm i uroj sukses dhe të përkrahet sporti dhe rinia sa me shumë.

Kryesuesi i Kuvendit- A ka dikush që dëshiron të diskutoj rreth kësaj pike?

Atëherë e hedh në votim,

Miratohet unanim nga anëtarët e pranishëm në mbledhje

Konstatohet që me 21 anëtar janë të pranishëm në sallë.

Shqyrtimi i pikës 10

Kryesuesi i Kuvendit - kalojmë piken e radhës Ndërrimi i emrit të projektit “Drenazhimi i fushës së sportit Demush Mavraj” me emrin e ri të projektit “Ndërtimi i Murit Rrethues të Stadiumit Demush Maraj”.

Zyrtari Kryesor Financiar, z. Osmon Sadikaj – bën prezantimin dhe sqarimin e Ndërrimi i emrit të projektit “Drenazhimi i fushës së sportit Demush Mavraj” me emrin e ri të projektit “Ndërtimi i Murit Rrethues të Stadiumit Demush Maraj”.

Ajshe Metaj – ndërtimi i mureve mbrojtëse dhe drenazhimi dallojnë për nga funksioni, tash a do të kullohet stadiumi apo do të mbrohet?

Kryetari i Komunës – Drenazhimi i stadiumit është i përfunduar ka vetëm plotësim të drenazhimit, dispozicionet kryesore janë muret mbrojtëse kjo është arsyeja edhe pse po

behet plotësim ndryshimi i emrit. Është projekt që është planifikuar në asamblenë e kaluar .

Kryesuesi i Kuvendit- faleminderit kryetar për sqarimin! A ka dikush që dëshiron të diskutoj rreth kësaj pike? Atëherë e hedh në votim,
Miratohet unanim nga anëtarët e pranishëm në mbledhje
Konstatohet që me 21 anëtar janë të pranishëm në sallë.

Kryesuesi i Kuvendit , falënderon të gjithë për durimin që patën, edhe pse në mbledhje vetëm 21 anëtar janë nuk është në rregull .
E shpallë të mbyllur mbledhjen e sotme. Faleminderit për pjesëmarrje, mirupafshim në mbledhjet e tjera.

Mbledhja përfundoi me punë në ora 12:50

Procesmbajtëse,
Vjosa Hysenaj



Kryesues i mbledhjes,
Enver Rugova

